

Ndryshimet në legjislacion

Maj – Qershor – Korrik 2017

Në këtë publikim:

- Ligji Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore;
- Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete;
- Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 04/2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente;
- Rregullore për Vlerën e Kontributeve të Pensionit/Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 05/2017 caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- Udhëzimi Administrativ MF-NR. 01/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ MF-NR 01/2015 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 për Leje Mjedisore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 Për Listën e Kategorive të Mbeturinave të Rrezikshme sipas Origjinës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale;
- Marrëveshja në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë Për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Republikës së Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2016;

1. Ligji Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 11 maj 2017 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 3, 31.01.2013).

Risitë kryesore që sjellë ky ligj janë përkufizimi i "regjistrat të llogarive bankare", dhe ndalimi i mjetit juridik kundër konkluzionit për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës. Ligji bazik parasheh se kreditori paraprakisht i paguan të gjitha shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbartimit, ndërsa me ndryshimet e reja, parashihet se tarifa e efikasitetit të përmbartimit është tarifë, e cila paguhet nga kreditori vetëm pas kryerjes së përmbartimit dhe deri në vlerën e përmbartuar dhe shuma e saj përcaktohet me marrëveshje në mes të kreditorit dhe përmbartuesit privat brenda kufirit maksimal dhe minimal të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit. Pra, me ndryshimet e reja përveç tarifës së efikasitetit të përmbartimit e cila përcaktohet me marrëveshje mes përmbartuesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhet nga kreditori, dhe pas përfundimit të procedurës ato i ngarkohen debitorit.

Më tutje, sipas ligjit të ri, për t'u konsideruar si dokument përmbartues marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin, ajo nuk duhet të jetë e vërtetuar nga Gjykata, siç është paraparë në Nenin 22 paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të Ligjit bazik.

Sipas ligjit bazik, në qoftë se me anë të aktvendimit për përbarim apo urdhrit për përbarim është caktuar pagimi i kamatave, atëherë llogaritjen e tyre, me shpenzime të kreditorit të përbarimit, e bënë organi përbarues, përpos kur realizimi i kamatave duhet të bëhet nga paratë e depozituara në llogarinë bankare. Ligji i ri këtë dispozitë e plotëson më tutje duke paraparë se llogaritjen e bën banka me shpenzimet e debitorit. Në rastet ku llogaritjen e bën banka, organi përbarues obligohet që në urdhrin përbarimor të shënojë shkallën e saktë të kamatës, udhëzimet e sakta për kohën e llogaritjes së kamatës, si dhe të gjitha detajet e tjera të nevojshme, në mënyrë që bankave t'iu mundësohet kalkulimi i kamatës në mënyrë të saktë. Në rast se në urdhrin përbarimor ka informata të pamjaftueshme, të paqarta, apo të pakompletuara, lidhur me llogaritjen e kamatës, organi përbarues obligohet që të plotësojë urdhrin përbarimor, sipas kërkesës së bankave.

Paragrafi 1 i Nenit 72 i ligjit bazik i cili parasheh afatin brenda të cilës Gjykata duhet t'ia dërgojë palës kundërshtare prapësimin kundër vendimit për përbarim fshihet tërësisht, dhe paragrafi 2 i të njëjtit nen riformulohet duke paraparë se organi përbarues ua dërgon prapësimin dhe provat mbështetëse palës kundërshtare dhe të gjitha palëve tjera në procedurën e përbarimit në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e pranimit të prapësimin. Gjykata po ashtu obligohet që të vendos për prapësimin në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të prapësimin. Ligji parasheh edhe ndryshime të tjera në lidhje me seancat e shitjes publike dhe e riformulon nenin 155 të ligjit bazik në lidhje me sekuestrimin dhe përbarimin në llogarinë bankare përmes Regjistrimit të Llogarive Bankare. Sipas këtyre ndryshimeve organi përbarues përmes sistemit elektronik të Regjistrimit të Llogarive Bankare ia dorëzon bankave komerciale aktvendimin apo urdhrin për përbarim në llogari bankare. Bankat komerciale obligohen të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të debitorit brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash prej momentit të pranimit të aktvendimit apo urdhrit për përbarim. Banka komerciale brenda afatit prej njëqind e njëzet (120) minutash e njofton organin përbarues për bllokimin e

llogarisë bankare sipas aktvendimit apo urdhrit për përbarim.

Ligji parasheh se brenda tetëmbëdhjetë (18) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë do të bëjë ndryshimin plotësimin e Udhëzimit Administrativ për tarifatat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përbaruesit privat. Deri atëherë, do të vlejnjë dispozitat e Udhëzimit Administrativ në fuqi.

2. Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 11 maj 2017 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve bazë të pajisjeve dhe instalimeve të cilat duhet ti ketë mjeti, dimensionin, masa më e madhe e lejuar dhe ngarkesa boshtore e mjetit si edhe kushtet të cilat duhet ti plotësoj mjeti në trafik, kushtet për importim, homologimin e tipit të mjetit, pjesës përbërëse, njësisë së pavarur teknike, kontrollimin teknik të automjeteve, kontrollimi i rregullsisë teknike në rrugë, regjistrimin e automjeteve, automjetet të cilat kanë dalë prej përdorimit si dhe çështjet tjera lidhur me to.

Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 2014/45/EC e datës 3 Prill 2014 për kontrollet teknike periodike; 2014/46/EC të datës 3 Prill 2014 për regjistrimin e automjeteve; 2014/47/EC të datës 3 Prill 2014 për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve komerciale në rrugë; 2007/46/EC të datës 5 Shtator 2007 për krijimin e një kornize për miratimin e automjeteve dhe rimorkiove të tyre, dhe të sistemeve të komponentëve dhe njësive të veçanta teknike të destinuara për automjetet të tilla (Direktive Kornize); 2000/53/EC të datës 18 Shator 2000 për automjetet jashtë përdorimit; 1999/37/EC të datës 29 Prill 1999 për dokumentet e regjistrimit të automjeteve.

Në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji zbatohet ligji në fuqi për kundërvajtjet përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj të gjitha institucioneve shtetërore, subjekteve juridike dhe pjesëmarrësve në trafikun rrugor.

Ligji parasheh gjoba nga 130€ deri në 600€ për shoferët/subjektet juridike të cilët nuk i plotësojnë kushtet e parapara për masën e përgjithshme, dimensionet, dhe ngarkimin boshtor të mjetit.

Ligji përjashton nga homologimi mjetet rrugore të projektuara dhe të dedikuara për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës ose për nevojat e zjarrfikësve; mjetet rrugore të dedikuara për përdorim në kantiere ndërtimi, mihje sipërfaqësore, gurore, limane dhe aeroporte; makinat e punës; mjetet rrugore shpejtësia më e madhe e konstruksionit të së cilave nuk është mbi 6 km/h; mjetet rrugore të dedikuara për rekreacion jashtë rrugëve publike; mopedët; pajisjen e makinave të konstruktura në mënyrë të veçantë për shfrytëzim në pylltari; pajisjen e makinave pyjore, pajisjen e instaluar në shasinë e mjetit rrugor për punë bujqësore; mjetet rrugore të cilat importohen përkohësisht që të përdoren në gara, panaire dhe manifestime të tjera të organizuara në Republikën e Kosovës, me ç'rast importimi i përkohshëm i këtyre mjeteve rrugore mund të zgjasë më së shumti tridhjetë (30) ditë; mjetet rrugore të dedikuara për ngasje në trafikun rrugor dhe të cilat nuk regjistrohen; mjetet rrugore të dedikuara ekskluzivisht për gara;

Përgjegjës për përcaktimin e kushteve, mënyrën dhe procedurën për dhënien e homologimit si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së homologimit është ministria përkatëse për transport.

Ky ligj, po ashtu përcakton kushtet për pjesëmarrjen në trafik. Çdo mjet motorik, para se të marrë pjesë në trafik duhet të regjistrohet. Sipas këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për:

- Procedurën për regjistrimin e mjeteve, dhënien dhe validitetin e certifikatës së regjistrimit të mjetit, targat, llojin, përmbajtjen dhe formën e targave të regjistrimit, targave provuese, ndryshimin e të dhënave si dhe çregjistrimin e mjeteve;
- Formën e certifikatës së regjistrimit të mjetit dhe format tjera të cilat përdoren në procedurën e regjistrimit të mjetit;

- Përcaktimi i çmimit për regjistrim të mjeteve si dhe çmimin e targave të regjistrimit dhe atyre provuese, të cilat i paguan pala.

Përjashtim nga rregulli i mësipërm bëjnë mjetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilat regjistrohen sipas procedurave të ministrisë përkatëse e forcës së sigurisë në Kosovë.

Sipas këtij ligji, në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë (10) vite, si dhe veturat që nuk e plotësojnë standardin Euro katër (4). Ky kufizim do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2018

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 02/L-70 për siguri në trafikun rrugor dhe të gjitha udhëzimet administrative që kanë dalë nga ky ligj.

3. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 04/2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente

Ky Udhëzim Administrativ është nxjerrë në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 05/L-081 për energjinë dhe se hynë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik.

Udhëzimi administrativ përcakton rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji, si dhe detyrimet e veçanta për ndërmarrjet e energjisë, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë së sistemit në situatat emergjente.

Sipas këtij Udhëzimi, Qeveria mund të merr vendim për aplikimin e masave kufizuese të furnizimit me:

- Energji elektrike
- Energji termike, dhe
- Gaz natyror

Aplikimi i masave kufizuese të mësipërme bëhet në rastet e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit për energjinë, përkatësisht rastet si në vijim:

- gjendjes së jashtëzakonshme, në pajtim me përcaktimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- në situata tjera emergjente, nëse Qeveria ka deklaruar se duhen masa emergjente në sektorin e energjisë;
- çfarëdo aksidenti material në instalimet për prodhimin, transmetimit apo shpërndarjen e energjisë elektrike, termike dhe gazit natyror;
- çfarëdo mungese të papritur ose afatgjate të kapacitetit prodhues energjetik ose kapacitetit të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë;
- çfarëdo aktiviteti terrorist dhe veprimi luftarak.

Sipas këtij Udhëzimi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik themelon Komitetin Teknik Emergjent me qëllim të këshillimit për ndikimin e mundshëm të situatës emergjente në furnizimin me energji, operimit dhe likuidimit të tregut të energjisë, menaxhimin e kësaj situate dhe për mënyrat e zvogëlimit të efekteve negative edhe në furnizim edhe në treg gjatë dominimit të situatës emergjente.

Pavarësisht masave kufizuese në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, ky Udhëzim Administrativ, parasheh përjashtimin e zbatimit të këtyre masave për aq sa është e mundur për kategoritë e mëposhtme:

- Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Objektet Ushtarake;
- Policia Kosovës, Zjarrfikësit, Shërbimi Korrektues dhe pikë kalimet kufitare;
- Minierat;
- Aeroportet;
- Veprimtaritë hekurudhore;
- Prodhuesit, transmetuesit, shpërndarësit dhe furnizuesit e licencuar të energjisë elektrike dhe termike;
- Kompanitë rajonale të ujësjellësit (mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit).
- Spitalet;
- Shërbimet postare, të telekomunikacionit dhe ato transmetuese;
- Çdo kategori apo industri tjetër të cilën Qeveria, pas konsultimit me Ministrinë dhe me Zyrën e Rregullatorit për

Energji, mund ta konsiderojë të nevojshëm.

Sipas Udhëzimit Administrativ, Ministri i Zhvillimit Ekonomik pas rekomandimit të Komitetit Teknik Emergjent në aplikimin e masave emergjente kufizuese mund të kërkojë nga ndërmarrjet e energjisë, që të:

- kufizojnë tregtimin me energji prej/në vendet e caktuara, gjatë periudhës së caktuar;
- krijojnë rezervat e karburanteve;
- bëjnë rregullime të tilla, sa i përket rezervave të karburanteve, për të:

a. mundësuar që këto rezerva të sillen brenda kohës së caktuar në nivelin e caktuar dhe të mirëmbahen në nivelin e caktuar; dhe

b. siguruar që ato rezerva të mos bien nën nivelin e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Mbikëqyrjen administrative të zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ e bënë Inspektorati I Energjisë që vepron në kuadër të Ministrisë dhe I cili i propozon Zyrës së Rregullatorit për Energji të vendos gjoba administrative në rast të veprimit të tyre në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-081 për Energji, Ligjin Nr.05/L-085 Energji Elektrike, Ligjin Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin Nr.05/L-052 për Energji termike dhe Ligjin Nr.05/L-082 për Gazin Natyror.

Secili konsumator dhe/apo pjesëmarrës në treg ka të drejtë që të paraqesë ankesë pranë autoritetit përgjegjës dhe/apo Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në rast të abuzimit të regjistruar apo tejkalimit të masës kufizuese.

4. Rregullore për Vlerën e Kontributeve të Pensionit/Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Kjo Rregullore është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më 27 prill 2017, në zbatim të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë.

Rregullorja aplikohet për Fondin Pensional Plotësues të Punëdhënësit ("Fond

Pensional”), dhe përshtatshëmrisht për Pensionet Plotësuese Individuale (Ofruesi i Pensionit), ndërsa qëllimi i saj është të përcaktojë kriteret minimale për përcaktimin e vlerës që mund të kontribuohet për programin e Pensionit plotësues.

Sipas kësaj Rregullore, Fondet Plotësuese Pensionale, duhet për çdo vit kalendarik përmes akteve normative të brendshme të përcaktojnë shumën e kontributeve si bazë për fitimin e pensionit plotësues.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulla 16 mbi Vlerën e Kontributeve Pensionale.

5. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 05/2017 caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme

Ky Udhëzim Administrativ është nxjerrë mbështetje të Nenit 13 paragrafi 1.2. të Ligjit Nr.05/L-081 për Energjinë.

Udhëzimi Administrativ përcakton caqet afatgjate dhe vjetore të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Udhëzimi Administrativ është pjesërisht në përputhje me dispozitat e Direktivës 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 Prill 2009 për promovimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

Sipas këtij Udhëzim, caku obligativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2020, është 25% i konsumit përfundimtar bruto të energjisë, siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimit të Këshillit Ministror të Komuniteti të Energjisë Nr. D/2012/04/MC-EnC. Ndërsa, caku indikativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme për vitin 2020 është 29.89% e konsumit përfundimtar bruto të energjisë.

Caqet vjetore të energjisë nga kapacitetet e reja të burimeve të ripërtëritshme për plotësimin e caqeve të vitit 2020 janë përcaktuar në shtojcën I të Udhëzimit, që është pjesë përbërëse e Udhëzimit.

Udhëzimi Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik.

6. Udhëzimi Administrativ MF-NR. 01/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ MF-NR 01/2015 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e nenit 26 të Udhëzimit Administrativ MF-Nr.01/2015 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale, respektivisht kriterëve dhe procedurat për nxitjen, motivimin, grumbullimin, aplikimin e fituesve potencial të kuponëve fiskal dhe rimbursimi i tyre.

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjithë personat që janë përcaktuar në fushëveprimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223.

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që aplikojnë për rimbursim nga grumbullimi i kuponëve fiskal në muajin pasues të çdo tre mujori, do të rimbursohen sipas kriterëve si në vijim:

1. Aplikimi bëhet on-line në sistemin e ATK-së, duke plotësuar informatat të cilat kërkohen në aplikacion, brenda afatit të përcaktuar. Aplikimi bëhet vetëm një herë për të njëjtën periudhë duke u bazuar në Numrin Personal të aplikuesit;
2. Numri Potencial Fitues gjenerohet nga Sistemi i ATK-së në bazë të një algoritmi të përcaktuar nga ATK, duke u bazuar në Numrin e Plikos, Emrin dhe Mbiemrin e qytetarit;
3. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, në një rënë nga datat 1 deri më 10 të muajit pasues ATK-ja në bashkëpunim me Lotarinë e Kosovës, do të organizoj tërheqjen e Fituesve Potencial (FP) përmes Televizionit Publik (TV) të Kosovës;
 - 3.1. Gjatë procesit të tërheqjes janë tre (3) Numra Potencial Fitues në qoftë se numri i fituesve është mbi 999 deri 4500;
 - 3.1.1. Nëse numri i fituesve të tërhequr nga Numrat Potencial

Fitues është më i vogël se njëmijë (1,000), atëherë duhet të tërhiqet edhe Numri Potencial Fitues shtesë deri në plotësimin e kushtit të paraparë.

3.1.2. Çdo Numër Potencial Fitues i tërhequr ka në vete maksimum njëmijepesëqind (1,500) fitues, në të kundërtën tërheqja përsëritet;

3.2. Numri minimal i kuponëve fiskal të dorëzuar duhet të jetë 60 kuponë, me shumën minimale dyqindpesëdhjetë euro (250 €);

3.3. Fituesit potencial rimbursohen me dhjetë përqind (10%) të vlerës së deklaruar, por jo më shumë se njëqind euro (100 €).

4. Aplikuesi me Numrin Potencial Fitues, të tërhequr në transmetimin e drejtpërdrejtë në TV, plikon e tij/saj me kuponë fiskal duhet ta dorëzojë fizikisht të mbyllur së bashku me të dhënat e aplikimit, në njërën nga Drejtoritë Regjionale të ATK-së.

Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi me 1 korrik 2017.

7. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 per Leje Mjedisore

Ky Udhëzim Administrativ u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 21.06.2017 dhe do të hyj në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor.

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të rregulloj kriteret për marrjen e lejes mjedisore për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në mjediset te veprimtarive publike dhe private.

Obligim për marrjen e lejes mjedisore sipas këtij udhëzimi administrativ kane të gjitha veprimtaritë të cilat kanë Pëlqim mjedisor. Udhëzimi administrativ gjithashtu rregullon si duhet të jetë forma e lejes mjedisore, si dhe përmbajtja e saj. Gjithashtu, ky udhëzim ka paraparë dhe procedurën e shqyrtimit te lejeve mjedisore duke filluar nga formimi i komisionit, shqyrtimi i

lëndës, marrja e vendimit për dhënien e lejes mjedisore.

Leja mjedisore mund të vazhdohet duke aplikuar për vazhdimin e saj, të paktën dy muaj para skadimit të lejes mjedisore. Leja mjedisore mund dhe të transferohet te pala e tretë, duke bërë kërkesë të veçantë në Ministri, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Udhëzimi administrativ ka parapare dhe mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e kërkesave të këtij udhëzimi. Mbikëqyrja do të bëhet nga inspektorati mjedisor sipas Ligjit për Mjedisin. Në raste të kundërvajtjes për mos zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi do të shqiptohen gjobat për personin juridik dhe personin fizike.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet udhëzimi me Nr.25.2012.

8. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 Për Listën e Kategorive të Mbeturinave të Rrezikshme sipas Origjinës;

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të udhëzoj personat fizik dhe juridik se si të përdorin listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës.

Ky Udhëzim Administrativ është pjesërisht në përputhje me disa dispozita të Konventës së Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkontinentale të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, e cila u miratua ne Mars 1989 dhe hyri në fuqi Maj 1992.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij udhëzimi, atëherë do shqiptohen gjoba në bazë të Ligjit për Mbeturina.

Ky udhëzim administrativ, si pjesë përbërëse ka Aneksin I.

9. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale

Ky udhëzim administrativ do të hyjë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Ministri i

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor.

Qëllimi i këtij udhëzimi është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis, të projekteve të propozuara, publike dhe private.

Me anë të këtij udhëzimi administrativ përcaktohen rregulla dhe procedurat për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe procedurat administrative gjatë procesit të vendimmarrjes për lëshimin e lejes mjedisore komunale.

Kusht për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale (LKM) është zbatimi i masave mbrojtëse të mjedisit sipas raportit dhe vendimit për LKM.

Autoriteti kompetent për lëshimin e LKM është Komuna.

Për të marr një leje të tillë, aplikuesi duhet të dorëzoj kërkesën tek Komuna, duke ja bashkangjitur Raportin për LKM i cili është përgatitur nga një person fizik apo juridik, dhe dokumente tjera siç janë të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

Vendimi për aprovim apo refuzim të lejes do të lëshohet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit. Në rast refuzimi, aplikuesi ka të drejtë të parashtoj ankesë brenda 15 ditëve nga data e pranimit të vendimit nga Komuna.

Poseduesi i LKM mund ta transferoj lejen e tij tek një person tjetër, mirëpo transferi duhet të miratohet nga Komuna.

Në rast se poseduesi i LKM nuk e fillon projektin në dy vite, atëherë validiteti i LKM do të ndërpritet.

Në rast shkeljes së dispozitave të këtij udhëzimi administrative, Inspektorati Komunal do të lëshoj gjoba siç parashihet me Ligjin për Kundërvajtje.

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrative, shfuqizohet udhëzimi administrative Nr. 17/2015.

10. Marrëveshja në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë Për shmangjen e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal

lidhur me tatimet mb të ardhurat dhe mbi kapitalin

Në mbështetje të dispozitave së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Presidentin, Ligjin mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Ligjin për Ministrin e Punëve të Jashtme, me 11 maj 2017 Presidenti ratifikoi Marrëveshjen për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

Kjo marrëveshje u nënshkrua në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë. Dhe do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim për përfundimin e procedurave të kërkuara me ligj për të sjellë në fuqi këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje do të aplikohet të personat të cilët janë rezidentë të një ose dy shtetet kontraktuese.

Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet marrëveshja janë:

Kosova:

- Tatimi mbi të ardhurat personale,
- Tatimi mbi të ardhurat e korporatave.

Kroacia:

- Tatimi mbi fitimin,
- Tatimi mbi të ardhurat,
- Tatimi mbi të ardhurat lokale dhe ndonjë ngarkesë tjetër të vendosur në një nga këto tatime.

Kjo marrëveshje do të mbes në fuqi deri sa një prej shteteve kontraktuese i jep shtetit tjetër njoftimin me shkrim për shpërbërje të kësaj marrëveshje, në ose para 30 qershorit në çdo vit kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe 5 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

11. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2016

Kjo marrëveshje është lidhur në Prishtinë, më 30.05.2017, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe

është publikuar në Gazetën Zyrtare më datën 12.07.2017.

Marrëveshje hyn në fuqi në ditën në të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Qëllimi për të cilin është lidhur kjo marrëveshje është dhënia e kontributit nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë në zhvillimin social dhe ekonomik të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Kosovës të marrë nga "Kreditanstalt für Eiederaufbau" shuma financimi me vlerë prej gjithsej 30 950 000 € (me fjalë: tridhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë euro).

Projektet për të cilat do të shfrytëzohen këto të holla janë:

- Programi i sektorit financiar rritje ekonomike dhe nxitje e punësimit në zonat rurale deri në 3 000 000 euro (me fjalë: tre milionë euro);
- Shkarkimi I ujërave të zeza në jug-perëndim Kosova VI, deri në 9 500 000 euro (me fjalë: nëntë milionë e pesëqind mijë euro);
- Programi për menaxhimin e mbeturinave II, deri në 1 000 000 euro (me fjalë: një milionë euro);
- Programi i efikasitetit energjetik-ngrohje komunale, deri në 5 000 000 euro (me fjalë: pesë milionë euro);
- Shërbime financiare për nxitjen e punësimit në sektorin e bujqësisë, deri në 5 450 000 euro (me fjalë: pesë milionë e katërqindpesëdhjetë mijë euro).

Nëse merren vesh Qeveria e Republikës së Federatës Gjermane me Qeverinë e Republikës së Kosovës këto projekte mund të zëvendësohen me projekte të tjera.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka për detyrë ta liroj "Kreditanstalt für

Eiederaufbau" nga taksat mbi qarkullimin dhe tatimet e tjera të tërthorta të cilat i mbulon Qeveria e Kosovës.

Në bazë të kësaj marrëveshje Qeveria e Kosovës është e detyruar që të mos e bëjë përjashtimin apo vështirësimin e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën e Gjermanisë.

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjedhën përmes ujdís ndërmjet palëve kontraktuese, në kuadër të bisedimeve, gjegjësisht negociatave.

Në rast të interpretimit të ndryshëm të teksteve të kësaj marrëveshje që janë në gjuhën shqipe, serbe, gjermane dhe angleze, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze

Kontaktet e Deloitte:

Afrore Rudi

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore dhe Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 590 807

Email: arudi@deloittece.com

Luljeta Plakolli - Kasumi

Menaxhere | Shërbime Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 780 769

Email: lplakollikasumi@deloittece.com



Përrjashtim i përgjegjësisë:

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.deloitte.al/about.

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuri të tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.